

32002R2204

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 2204/2002 e 12 dhjetorit 2002 për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së në ndihmën shtetërore për punësimin

Gazeta Zyrtare L 337, 13/12/2002 faqe 0003 - 0014

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 2204/2002 e 12 dhjetorit 2002 për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së në ndihmën shtetërore për punësimin

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EVROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 994/98 e 7 majit 1998 për zbatimin e neneve 92 dhe 93 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian për disa kategori të ndihmës shtetërore horizontale dhe, në veçanti, shkronja (a)(iv) dhe shkronja (b) e nenit 1(1) të tij,

Duke publikuar një projekt të kësaj rregulloreje(2),

Duke u konsultuar me Komitetin Këshillues për Ndihmën Shtetërore,

Duke pasur parasysh se:

(1) Rregullorja (KE) nr. 994/98 autorizon Komisionin të deklarojë që në përputhje me nenin 87 të Traktatit, në kushte të caktuara, ndihma për punësim të jetë në përputhje me tregun e përbashkët dhe, si e tillë, të mos jetë subjekt i kërkesës për njoftim sipas nenit 88(3) të Traktatit.

(2) Gjithashtu, Rregullorja (KE) nr. 994/98 autorizon Komisionin të deklarojë se në përputhje me nenin 87 të Traktatit, ndihma që është në përputhje me hartën për dhënien e ndihmës rajonale të miratuar nga Komisioni për çdo Shtet Anëtar, është në përputhje me tregun e përbashkët dhe, si e tillë, nuk është subjekt i kërkesës për njoftim sipas nenit 88(3) të Traktatit.

(3) Komisioni i ka zbatuar nenet 87 dhe 88 të Traktatit për ndihmën për punësim, në zonat e asistuar dhe jashtë tyre, në shumë vendime duke krijuar edhe politikën e vet në udhëzimet e ndihmës për punësim, në njoftimin për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe uljen e kostove të punës, në udhëzimet për ndihmën kombëtare rajonale dhe në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 70/2001 e 12 janarit 2001 për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Duke pasur parasysh përvojën e Komisionit për zbatimin e këtyre dispozitave, është e nevojshme që Komisioni të përdorë kompetencat e dhëna nga Rregullorja (KE) nr.

994/98, me qëllim që të sigurohet një mbikëqyrje e frytshme dhe administrim i thjeshtë, pa dobësuar kontrollin e Komisionit.

(4) Kjo rregullore nuk cenon mundësinë e Shteteve Anëtare për të njoftuar ndihmën për punësim. Njoftime të tilla do të vlerësohen nga Komisioni, veçanërisht duke pasur parasysh kushtet e dhëna në këtë Rregullore, në Rregulloren (KE) nr. 70/2001 ose në përputhje me çdo udhëzim ose kuadër ligjor të Komunitetit, sikurse në rastin e sektorit të transportit detar. Udhëzimet për ndihmën shtetërore për punësimin nuk zbatohen më prej datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, ashtu si njoftimi mbi kontrollin e ndihmës shtetërore, mbi uljen e kostove të punës dhe mbi njoftimin për një procedurë të përsheptuar për shqyrtimin e njoftimeve të ndihmës së punësimit. Njoftimet e mbetura pezull në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të vlerësohen në përputhje me dispozitat e saj. Është e nevojshme të përcakohen dispozita kalimtare në lidhje me zbatimin e Rregullores në ndihmën për punësim, të dhënë para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, e cila është në kundërshtim me detyrimet e nenit 88(3) të Traktatit.

(5) Nxitja e punësimit është një synim kryesor i politikave ekonomike dhe sociale të Komunitetit dhe shteteve të tij anëtare. Komuniteti ka zhvilluar një strategji Evropiane për punësim, me qëllim që t'i japë shtysë këtij objekti. Papunësia mbetet një problem i rëndësishëm në disa pjesë të Komunitetit dhe në disa kategori punonjësish, të cilët ndeshen ende me vështirësitë, veçanërisht, për hyrjen në tregun e punës. Për këtë arsye, ekziston një shfajësim, ku autoritetet publike duhet të zbatojnë masa të cilat sigurojnë nxitje të ndërmarrjet për të rritur nivelin e tyre të punësimit, veçanërisht, të punonjësve me këto kategori në vështirësi.

(6) Kjo rregullore zbatohet vetëm për masat e punësimit që përmbushin të gjitha kushtet e nenit 87 pika (1) të Traktatit dhe në këtë mënyrë përbëjnë ndihmë shtetërore. Një numër masash të politikave të punësimit nuk përbëjnë ndihmë shtetërore sipas kuptimit të nenit 87 pika (1) sepse ato janë ndihma për individët; masat e politikave nuk favorizojnë ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e të mirave të caktuara ose sepse ato nuk ndikojnë në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare, ose sepse ato janë masa të përgjithshme për nxitjen e punësimit të cilat nuk shtrembërojnë ose kërcënojnë të shformojnë konkurrencën, duke favorizuar, kështu, ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e të mirave të caktuara. Këto masa të përgjithshme, të cilat mund të përfshijnë uljen e përgjithshme të taksave për punën dhe kostot sociale, duke rritur investimet në arsimin e përgjithshëm dhe në trajnimin e tyre, masat, që ofrojnë këshillime dhe udhëzime, asistencat e përgjithshme, trajnimi për të papunët dhe përmirësimi i legjislacionit të punës, janë në këtë mënyrë të pa ndikuara nga kjo rregullore. Gjithashtu kjo vlen edhe për masat, të cilat mendohet se nuk i përmbushin të gjitha kushtet e nenit 87 pika (1) të Traktatit dhe në këtë mënyrë, nuk kërkojnë njoftim sipas nenit 88 pika (3) të Traktatit, duke u mbështetur në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 69/2001 të datës 12 janar 2001 për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën "*de minimis*".

(7) Duke pasur parasysh këto rrethana, qëllimi dhe efektet e ndihmës së përjashtuar nga kjo Rregullore, duhet të jenë për nxitjen e punësimit, në veçanti për punonjësit në vështirësi, në përputhje me Strategjinë Evropiane të Punësimit. Kjo nuk duhet të ketë

ndikim në kushtet e tregtisë në atë masë sa të krijojë probleme për interesin e përgjithshëm. Ndihma për punësimin e dhënë mbi baza individuale, mund të ketë ndikim më të madh mbi konkurrencën në tregun përkatës, sepse ajo krijon përparësi për një ndërmarrje kundrejt ndërmarrjeve të tjera që nuk marrin një ndihmë të tillë. Nëse ndihma jepet vetëm për ndërmarrje të caktuara, ajo ka vetëm një efekt të kufizuar mbi punësimin. Për këtë arsye, dhëniet individuale të ndihmës për punësim do të vazhdojnë të njoftohen pranë Komisionit dhe kjo Rregullore do të përjashtojë vetëm ndihmën e dhënë në formën e skemave.

(8) Kjo Rregullore do të përjashtojë çdo ndihmë të dhënë sipas një skeme, që përmbush të gjitha kushtet përkatëse të Rregullores. Skemat e ndihmës duhet të përmbajnë një referencë të saktë në Rregullore, me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja efektive dhe administrimi i thjeshtë, pa dobësuar kontrollin e Komisionit.

(9) Kjo Rregullore nuk do të përjashtojë nga njoftimi ndihmën shtetërore në sektorët e ndërtimit të anijeve dhe qymyrgurit, për të cilët ekzistojnë rregulla të veçanta, përkatësisht në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1540/98 dhe Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1407/2002.

(10) Kjo Rregullore do të zbatohet në sektorin e transportit. Megjithatë, duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të konkurrencës në këtë sektor, nuk është e përshtatshme të përjashtohet ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës.

(11) Komisioni ka një qëndrim të vazhdueshëm jofavorizues për ndihmën që synon sektorë të veçantë përfshirë sektorët e ndjeshëm, të cilët shfaqin kapacitete të tepërta ose kriza. Në këtë mënyrë, skemat e ndihmës, të cilat synojnë sektorë të caktuar, nuk do të përfitojnë nga përjashtimi prej njoftimit sipas kësaj Rregullore.

(12) Sipas praktikës së Komisionit, për të siguruar që ndihma është e përpjestueshme dhe e kufizuar në madhësinë e nevojshme, duhet që kufijtë të mos shprehen në termat e vlerave më të larta të ndihmës, por në termat e intensitetit të ndihmës në lidhje me një grup kostosh të pranueshme.

(13) Me qëllim që të përcaktohet nëse ndihma është apo jo në përputhje me tregun e përbashkët, sipas kësaj Rregulloreje, është e nevojshme që të merret parasysh intensiteti i ndihmës dhe në këtë mënyrë, vlera e ndihmës e shprehur si një ekuivalent granti. Llogaritja e ekuivalentit të grantit për ndihmën e paguar në disa këste dhe për ndihmën në formën e një kredie të zbutur, kërkon përdorimin e normave të interesit që mbizotrojnë në treg në momentin e grantit. Për të pasur një zbatim uniform, transparent dhe të thjeshtë të rregullave të ndihmës shtetërore, supozohet që normat e tregut që përdoren për këtë Rregullore të jenë si norma reference, me kusht që në rastin e kredive të lehta, kredia e kthyer të përbëjë një risk normal. Normat e referencës do të jenë ato që janë fiksuar herëpashere nga Komisioni mbi bazën e kushteve objektive dhe janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian dhe në internet.

(14) Duke pasur parasysh diferencat ndërmjet ndërmarrjeve të madhësive të ndryshme, duhet të vendosen kufij të ndryshëm të intensitetit të ndihmës për krijimin e vendeve të reja të punës nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe nga ndërmarrjet e mëdha. Me qëllim që të eliminohen diferencat të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën si dhe të lehtësohet bashkërendimi ndërmjet iniciativave të ndryshme Komunitare dhe kombëtare për qartësinë administrative dhe sigurinë ligjore, përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) i përdorur në këtë Rregullore, duhet të jetë ai i dhënë në Këshillimin e Komisionit 96/280/KE e datës 3 prill 1996, lidhur me përkufizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ai përkufizim është përdorur edhe në Rregulloren (KE) nr. 70/2001.

(15) Kufijtë i intensitetit të ndihmës duhet të fiksohen në një nivel që, sipas përvojës së Komisionit, të vendosin balancën e duhur ndërmjet minimizimit të shtrembërimit të konkurrencës dhe objektivit të nxitjes së punësimit. Për të pasur një lidhje logjike duhet që kufijtë të jenë të harmonizuar me ata të fiksuar në udhëzimet për ndihmën kombëtare rajonale dhe në Rregulloren (KE) nr. 70/ 2001, kjo e fundit, lejon që ndihma të llogaritet duke iu referuar krijimit të vendeve të punës lidhur me projektet e investimit.

(16) Kostot e punësimit përbëjnë një pjesë të kostove normale të veprimtarisë për çdo ndërmarrje. Prandaj është shumë e rëndësishme që ndihma të ketë një efekt pozitiv mbi punësimin dhe nuk duhet që ndihma thjesht t'u krijojë mundësi ndërmarrjeve që të ulin kostot të cilat ato do t'i kishin përballuar nëse nuk do kishin përfituar ndihmën.

(17) Pa kontrolle të rrepta dhe kufizimet e duhura, ndihma për punësimin mund të ketë efekte të dëmshme, të cilat eliminojnë efektet e menjëhershme që vijnë nga krijimi i vendeve të reja të punës. Nëse ndihma është përdorur për të mbrojtur ndërmarrjet që të përballojnë konkurrencën ndërkomunitare, ajo mund të ketë si pasojë vonesën në përshtatjet e nevojshme për të siguruar konkurrueshmërinë e industrisë komunitare. Në mungesë të kontrolleve të rrepta, një ndihmë e tillë mund të përqendrohet në rajonet më të zhvilluara, duke qenë kështu, në kundërshtim me objektivin e kohezionit ekonomik dhe social. Brenda tregut të përbashkët, ndihma e dhënë për të ulur kostot e punësimit mund të çojë në shtrembërimin e konkurrencës ndërkomunitare dhe në shmangien e shpërndarjeve të burimeve dhe investimeve të lëvizshme, duke kaluar papunësinë nga një vend në tjetrin dhe duke bërë një rishpërndarje.

(18) Ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës duhet të përmbushë kushtin që vendet e reja të krijuara të ruhen për të paktën një periudhë të caktuar. Periudha e dhënë në këtë rregullore duhet të mos kalojë afatin pesë vjeçar të dhënë në pikën 4.14 të udhëzimeve për ndihmën kombëtare rajonale.

(19) Ndihma për ruajtjen e vendeve të punës është mbështetja financiare që i jepet një ndërmarrjeje për ta bindur atë të mos pushojë punonjësit e saj. Kjo kategori ndihme është e ngjashme me ndihmënvepruese. Prandaj, për sa i përket ndonjë rregulli sektorial, të tilla si ato që ekzistojnë në sektorin e transportit detar, ndihma duhet të autorizohet vetëm në rrethana të veçanta dhe për një periudhë të kufizuar kohe. Ajo do të vazhdojë të njoftohet pranë Komisionit dhe nuk do të përjashtohet nga njoftimi në bazë të kësaj rregulloreje.

Rrethanat e veçanta në të cilat ndihma mund të autorizohet , përfshi ato, kur sipas nenit 87(2)(b) të Traktatit, synon të eliminojë dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose situatat e jashtëzakonshme; një rast tjetër është ,sipas kushteve, zbatimi për ndihmën vepruese tek udhëzimet për ndihmën kombëtare rajonale, në ato rajone ku është e lejueshme një përjashtim sipas nenit 87(3)(a) të Traktatit, lidhur me zhvillimin e zonave ku standardet e jetesës janë jashtëzakonisht të ulta ose kur ka një papunësi serioze, përfshi rajonet shumë periferike; një rast të tretë kemi atëherë kur një ndihmë e tillë është dhënë për shpëtimin dhe ristrukturimin e një ndërmarrjeje në vështirësi, në përputhje me dispozitat e udhëzimeve përkatëse të Komunitetit.

(20) Një lloj i veçantë ndihme është ndihma e dhënë për punonjësit për shndërrimin e kontratave të punësimit të përkohshëm ose me terma të fiksuara, në kontrata me kohëzgjatje të papërcaktuar. Masa të tilla nuk do të përfshihen nga përjashtimi dhe duhet të njoftohen, me qëllim që Komisioni të mund të përcaktojë nëse ato kanë efekte pozitive mbi punësimin. Duhet të sigurohemi, veçanërisht, që masa të tilla nuk lejojnë që punësimi të ndihmohet si në momentin e krijimit të vendeve të punës, ashtu edhe në momentin e shndërrimit të kontratës në atë shkallë, sa të kalohet kufiri i ndihmës për investimin fillestar ose për krijimin e vendeve të reja të punës.

(21) Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luajnë një rol vendimtar në krijimin e vendeve të reja të punës. Por nga ana tjetër, madhësia e tyre mund të paraqesë një mospërfitim për krijimin e vendeve të reja të punës, për shkak të riskut dhe pengesave administrative për rekrutimin e personelit të ri. Në mënyrë të ngjashme, krijimi i vendeve të punës mund të kontribuojë në kohezionin ekonomik dhe social, veçanërisht, për zonat e thella. Ndërmarrjet në ato rajone vuajnë nga disavantazhe strukturore të vendndodhjes. Në këtë mënyrë është me vend që ndërmarrjet e vogla e të mesme dhe ndërmarrjet në rajonet e ndihmuara, të mund të përfitojnë nga ndihma për krijimin e vendeve të punës.

(22) Ndërmarrjet e mëdha në zonat e zhvilluara nuk vuajnë nga vështirësi të veçanta dhe kostot e punësimit janë pjesë normale e shpenzimeve të tyre operacionale. Për këtë arsye, dhe me qëllim që të maksimizohet efekti nxitës i ndihmës për krijimin e vendeve të punës nga SME-të dhe në rajonet e lejuara për përjashtim nga neni 87(3) pikat (a) dhe (c) i Traktatit, ndërmarrjet e mëdha në rajonet që nuk janë të lejuara për këtë përjashtim, nuk do të jenë të pranueshme për ndihmë në krijimin e vendeve të punës.

(23) Kategori të caktuara punonjësish përjetojnë vështirësi të veçanta për të gjetur punë, sepse punëdhënësit i konsiderojnë ata si më pak produktivë. Frytshmëria mund të perceptohet më e ulët për shkak të mungesës së përvojës së mëparshme (për shembull: punëtorët e rinj, të papunët për një kohë të gjatë) ose kanë një paaftësi të përhershme. Ndihma e punësimit që synon të nxitë ndërmarrjet të marrin në punë këta individë është e përligjur nga fakti se produktiviteti më i ulët i këtyre punonjësve ul përparësitë financiare që mund të ketë ndërmarrja , si dhe nga fakti, sepse nga masat e marra përfitojnë gjithashtu edhe punonjësit, të cilët mund të përjashtohen nga tregu i punës nëse nuk iu ofrohen këto stimuj. Prandaj duhet të lejohen skemat që ofrojnë të tillë ndihmë, pavarësisht nga madhësia dhe vendndodhja e përfituesit.

(24) Duhet të përcaktohen kategoritë e punonjësve që vlerësohen si në vështirësi, por duhet të krijohet një mundësi që shtetet anëtare të mund të njoftojnë ndihmën për nxitjen e marrjes në punë edhe të kategorive të tjera të cilat ata i konsiderojnë si në vështirësi, duke e bazuar këtë në dokumentet mbështetëse.

(25) Punonjësit me një paftësi të përhershme mund të kenë nevojë për ndihmë të vazhdueshme që do t'u mundësonte atyre të mbeteshin në tregun e punës, duke shkuar kështu më tej sesa ndihma për marrjen fillestare në punë dhe, ku mund t'u përfshihej edhe sigurimi i përhershëm I punës. Skemat që ofrojnë ndihmë për këtë qëllim, do të përjashtohen nga njoftimi me kusht ,në mënyrë që ndihma të tregojë qartë se ajo nuk tejkalon vlerën e nevojshme për të kompensuar produktivitetin më të ulët të punonjësve në fjalë. Ky kusht është vendosur për të parandaluar ndërmarrjet që mund të përfitojnë nga një ndihmë e tillë, për të shitur nën vlerën e çmimeve konkurruese të tregjeve që ofrojnë edhe ndërmarrjet e tjera.

(26) Kjo Rregullore nuk ndalon përshpejtimin e ndihmës për marrjen në punë të punonjësve në vështirësi ose për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara nga ndihmat e tjera të dhëna për kostot e punësimit, përderisa është e ligjshme të ofrohet një stimul ,që punonjësit e këtyre kategorive të jenë më të preferuar për t'u punësuar në krahasim me të tjerët.

(27) Kjo rregullore, nuk do të përjashtojë ndihmën për krijimin e vendeve të punës ose për marrjen në punë të punonjësve, të cilat përfituesi do t'i kishte realizuar edhe sipas vetë kushteve të tregut, por nga ana tjetër, siguron se ndihma është e nevojshme dhe vepuron si një stimul për punësimin.

(28) Kjo rregullore nuk do të përjashtojë ndihmën për krijimin e vendeve të punës kur një ndihmë e tillë është e akumuluar me ndihma të tjera shtetërore, përfshirë ndihmën e dhënë nga autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, ose me asistencën Komunitare për të njëjtat kosto të pranueshme, ose kostot e investimeve për të cilat është i lidhur punësimi në fjalë, kur një përshtim i tillë kalon kufijtë e përcaktuar në këtë rregullore ose në rregullat e Komunitetit për ndihmën shtetërore për investim, veçanërisht sipas udhëzimeve për ndihmën kombëtare rajonale dhe Rregulloren (KE) nr. 70/2001. Përjashtimi i vetëm nga ky parim do të jetë ndihma për marrjen në punë të punonjësve në vështirësi, ose për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara.

(29) Vlerat e mëdha të ndihmës duhet që të vlerësohen individualisht nga Komisioni përpara se ato të vihen në zbatim. Prandaj, vlerat e ndihmës për një ndërmarrje të vetme ose për një skemë, që kalojnë një vlerë të fiksuara gjatë një periudhe të caktuar, nuk plotësojnë kushtet për përjashtimin e dhënë në këtë Rregullore dhe mbeten subjekt i kërkesave të nenit 88(3) Traktati (30). Masat e ndihmës për të nxitur punësimin ose ndihma që lidhen me objektiva të tjerë për punësimin dhe tregjet e punës, mund të jenë të një natyre të ndryshme nga masat e përjashtuara nga kjo rregullore. Këto masa duhet të njoftohen sipas nenit 88(3).

(31) Në këndvështirimin e Marrëveshjes së Organizatës Botrore të Tregtisë (OBT) për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese, kjo rregullore nuk do të përjashtojë ndihmën për eksport ose ndihmën që krijon përparësi për produktet vendase kundrejt produkteve të importuara.

Një ndihmë e tillë nuk do të jetë e përputhur me detyrimet ndërkombëtare të Komunitetit sipas asaj Marrëveshjeje dhe, në këtë mënyrë, nuk do të përjashtohen nga njoftimi ose nuk do të autorizohen nëse janë njoftuar.

(32) Me qëllim që të sigurohet transparenca dhe kontrolli efektiv, në përputhje me nenin e Rregullores (KE) nr. 994/98, është e nevojshme që të krijohet një format standard, me të cilin shtetet anëtare do të sigurojnë për Komisionin një përmbledhje të informacionit sa herë që në zbatim të kësaj rregulloreje, të zbatohet një skemë ndihme. Kjo është e domosdoshme për publikimin në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian. Për të njëjtat arsye, është e nevojshme të krijohen rregulla në lidhje me të dhënat që shtetet anëtare duhet të ruajnë lidhur me skemat e ndihmës, të përjashtuara nga kjo rregullore. Për të përgatitur raportin vjetor që do të dërgohet pranë Komisionit nga shtetet anëtare, është e nevojshme që Komisioni të paraqesë kërkesat e veçanta të tij. Me qëllim që të lehtësohet trajtimi administrativ dhe në këndvështirimin e disponueshmërisë së gjerë të teknologjisë së nevojshme, informacioni përmbledhës dhe raporti vjetor duhet të sigurohet në formë kompjuterike.

(33) Duke pasur parasysh përvojën e Komisionit në këtë fushë dhe, në veçanti, frekuencën me të cilën duhet rishikuar politika e ndihmës shtetërore, është e nevojshme që të kufizohet periudha e zbatimit të kësaj rregulloreje. Sipas nenit 4(2) të Rregullores (KE) nr 994/ 98, është e nevojshme të përfshihen dispozita të përkohshme, me anë të të cilave skemat e ndihmës, tashmë të përjashtuara nga kjo rregullore në momentin e shfuqizimit të saj, të vazhdojnë të përjashtohen edhe për gjashtë muaj të tjera.

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE :

Neni 1

Qëllimi

1 Kjo rregullore do të zbatohet për skemat që përbëjnë ndihmë shtetërore sipas kuptimit të nenit 87(1) të Traktatit dhe , që sigurojnë ndihmë për krijimin e punësimit, ndihmë për marrjen në punë të punonjësve në vështirësi dhe të personave me aftësi të kufizuara, ose ndihmë për të mbuluar kostot shtesë të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

2. Kjo rregullore do të zbatohet në ndihmë të të gjithë sektorëve , përfshirë veprimtaritë që lidhen me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të listuara në Shtojcën I të Traktatit.

Ajo nuk do të zbatohet për ndihmat e dhëna në sektorët e qymyrgurit dhe ndërtimit të anijeve, as edhe për ndihmat për krijimin e punësimit, sipas nenit 4, të dhëna në sektorin e transportit. Ndihma të tilla, në përputhje me nenin 88(3) të Traktatit, do të mbeten subjekt i njoftimit paraprak pranë Komisionit,.

3. Kjo Rregullore nuk do të zbatohet:

(a) në ndihmën për veprimtaritë e lidhura me eksportin, kryesisht ndihma e lidhur drejtëpërdrejtë me sasi të eksportuara, për krijimin dhe funksionimin e një rrjeti shpërndarje ose shpenzimet e tjera korrente, të lidhura me veprimtarinë e eksportit;

(b) në ndihmën që krijon përparësi për përdorimin e produkteve vendase kundrejt atyre të importuara.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Rregullore:

(a) “ndihmë” nënkupton çdo masë që përmbush të gjitha kushtet e dhëna në nenin 87 pika

(1) të Traktatit;

(b) “ndërmarrje të vogla dhe të mesme” nënkupton ndërmarrjet e përcaktuara në Shtojcën I të Rregullores (KE) nr. 70/2001;

(c) “intesiteti bruto i ndihmës” nënkupton vlerën e ndihmës së shprehur si përqindje e kostove përkatëse.

Të gjitha të dhënat e përdorura duhet të merren përpara zbritjes së taksimit të drejtëpërdrejtë. Kur ndihma nuk është dhënë në formë granti por në ndonjë formë tjetër, atëherë vlera e ndihmës do të jetë ekuivalenti i grantit të ndihmës. Ndihma e pagueshme në disa këste, duhet të skontohet në vlerën e saj që në momentin e dhënies. Norma e interesit, që do të përdoret për skontimin dhe për llogaritjen e vlerës së ndihmës në formën e një kredie të zbutur, do të jetë norma e referencës së përdorur në momentin e dhënies;

(d) “intesiteti neto i ndihmës” nënkupton vlerën e skontuar e ndihmës së shprehur si përqindje e kostove përkatëse;

(e) “numri i punonjësve” nënkupton numrin e njësisve vjetore të punës (NJVP), që do të thotë numri i personave të punësuar me kohë të plotë gjatë një viti. Personat e punësuar me kohë të pjesshme dhe ata sezonalë do të llogariten si fraksione të NJVP;

(f) “punonjës në vështirësi” nënkupton çdo person i cili i përket një kategorie shoqërore, e cila pa patur një përkrahje e ka të vështirë të hyjë në tregun e punës, kryesisht një person i cili përmbush të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

- (i) çdo person i cili është nën 25 vjeç ose që ka dy vjet që ka mbaruar arsimin pa shkëputje nga puna dhe që nuk ka pasur një punë të parë të rregullt dhe të paguar;
- (ii) çdo punonjës emigrant që lëviz ose ka lëvizur brenda Komunitetit për të punuar ,ose bëhet rezident në Komunitet;
- (iii) çdo person që është një anëtar i një minoriteti etnik brenda Shtetit Anëtar dhe që kërkon zhvillimin e aftësive të tij/saj ligjore, trajnim profesional ose përvojë pune për të përmirësuar shpresat e tij për të filluar një punë të qëndrueshme;
- (iv) çdo person që dëshiron të hyjë ose të rihyjë në punë, i cili ka qënë pa punë dhe nuk ka qënë duke u arsimuar për dy vitet e fundit, veçanërisht, çdo person i cili lë punën për shkak të vështirësive për të përballuar punën dhe familjen;
- (v) çdo person që jeton si beqar i rritur dhe që ka në ngarkim një ose më shumë fëmijë;
- (vi) çdo person që nuk ka kryer arsimin e mesëm ose ekuivalentin e tij, që nuk ka një punë ose që ka humbur punën e tij/ saj;
- (vii) çdo person më i madh se 50 vjeç, që nuk ka një punë ose që ka humbur punën e tij/saj;
- (viii) çdo person që ka një periudhë të gjatë pa punë, p.sh. çdo person që ka qënë pa punë për 12 nga 16 muajt e fundit, ose gjashtë nga tetë muajt e fundit , për personat nën 25 vjeç;
- (ix) çdo person që njihet se ka qënë një i droguar sipas ligjeve kombëtare;
- (x) çdo person që nuk ka filluar punën e tij të parë të rregullt dhe të paguar, që nga fillimi i periudhës së burgosjes ose masave të tjera penale;
- (xi) çdo grua në një zonë gjeografike NUTS II, ku papunësia mesatare i kalon 100% të mesatares së Komunitetit, për të paktën dy vite kalendarike dhe kur papunësia për femrat ka kaluar 150% të normës së papunësisë së meshkujve në zonën në fjalë, për të paktën dy nga tre vitet e mëparshme kalendarike;
- (g) “punonjës me aftësi të kufizuar” nënkupton çdo person i cili:
(i)njihet si i tillë në bazë të legjislacionit kombëtar ose:
(ii) ka një dëmtim fizik, mendor dhe psikologjik serioz dhe të njohur;
- (h) “punësimi me strehim” nënkupton punësimin në një ndërmarrje ku të paktën 50% e të punësuarëve janë punonjës më aftësi të kufizuara, të cilët nuk janë të aftë te zënë një vend pune në tregun e hapur të punës;

(i) “kosto e pagave” përfshijnë elementët në vazhdim ,që aktualisht paguhen nga përfituesi i ndihmës shtetërore në lidhje me ndihmën në fjalë;

(i) paga bruto, d.m.th përpara tatimit dhe;

(ii) kontributet e sigurimeve të detyrueshme shoqërore;

(j) një vend pune është “i lidhur me zbatimin e një projekt investimi” , nëse ai i përket veprimtarisë me të cilën lidhet investimi dhe, nëse ai është krijuar brenda tre viteve pas përfundimit të investimit. Gjatë kësaj periudhe, vendet e punës të krijuara si pasojë e rritjes së normës së shfrytëzimit të kapacitetit ,të krijuar nga investimi ,janë gjithashtu të lidhura me investimin;

(k) “investim në asete të prekshme” nënkupton një investim në asete fizike fikse për krijimin e një ndërmarrje, zgjerimin e një ndërmarrje ekzistuese ose angazhimi në një veprimtari ,që do mundësojë një ndryshim rrënjësor në produktet ekzistuese ose proceset ekzistuese të prodhimit, në një ndërmarrje ekzistuese (në veçanti nëpërmjet racionalizimit, shumëllojshmërisë ose modernizimit).

Gjithashtu, do të konsiderohet si një investim i prekshëm edhe një investim në asete fikse i ndërmarrë në formën e blerjes së një ndërmarrje, e cila ka falimentuar ose që do të kishte

falimentuar nëse nuk do të blihej;

(l) “investim në asete të paprekshme” nënkupton investim në transferimin e teknologjisë nëpërmjet blerjes së patentave, liçencave, njohurive të patentuara ose njohuri teknike të papatentuara.

Neni 3

Kushtet për përjashtim

1. Duke pasur parasysh dispozitat e nenit 9, skemat e ndihmës që përmbushin të gjitha kushtet e kësaj rregullore ,do të jenë në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 78(3) të Traktatit dhe do të përjashtohen nga detyrimi i njoftimit, sipas nenit 88(3) të Traktatit, me kusht që:

(a) çdo ndihmë që mund të jepet sipas kësaj skeme të përmbushë të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje ;

(b) skema të përmbajë një referencë të qartë të kësaj Rregulloreje, duke cituar titullin e saj dhe referencën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.

2. Ndhimja e dhënë sipas skemave të cituara në paragrafin 1 ,do të jetë në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 87 pika (3) me kusht që ndihma e dhënë, të përmbushë të gjitha kushtet e kësaj rregullore.

Neni 4

Krijimi i vendeve të punës

1 Skemat e ndihmës për krijimin e vendeve të punës dhe çdo ndihmë që mund të jepet sipas këtyre skemave, duhet të përmbushin kushtet e paragrafëve 2, 3 dhe 4.

2 Kur vendet e reja të punës janë krijuar në zonat ose në sektorët të cilët, në momentin që jepet ndihma, nuk kualifikohen për ndihmë rajonale sipas nenit 87(3)(a) dhe (c), atëherë intensiteti bruto i ndihmës nuk duhet të kalojë:

- (a) 15 % në rastin e ndërmarrjeve të vogla;
- (b) 7,5 % në rastin e ndërmarrjeve të mesme.

3. Kur vendet e reja të punës janë krijuar në zonat dhe sektorët të cilët, në momentin që jepet ndihma, kualifikohen për ndihmë rajonale sipas nenit 87(3)(a) dhe (c), intensiteti neto i ndihmës nuk duhet të kalojë tavanin e intensitetit të ndihmës rajonale për investim, të përcaktuar në hartën rajonale që zbatohet në momentin që jepet ndihma, ashtu siç është miratuar nga Komisioni për çdo Shtet Anëtar. Për këtë qëllim, midis të tjerash, duhet mbajtur parasysh edhe kuadri multisektorial për ndihmën rajonale në projektet e mëdha të investimit.

Në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pavarësisht se harta parashikon ndryshe për këto ndërmarrje, ky tavan do të rritet me:

(a) 10 përqind pikë bruto në zonat që mbulohen nga neni 87(3)(c), me kusht që intensiteti total neto i ndihmës të mos kalojë 30% ose;

(b) 15 përqind pikë bruto në zonat që mbulohen nga neni 87(3)(a), me kusht që intensiteti total neto i ndihmës të mos kalojë 75%.

Tavanet më të lartë rajonale do të zbatohen vetëm, nëse kontributi i përfituesit është të paktën 25% dhe, nëse punesimi ruhet brenda rajonit të kualifikuar.

Kur punësimi krijohet në prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të listuara në Shtojcën I të Traktatit, në zonat të cilat kualifikohen si zona të prapambetura sipas Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1257/1999, do të zbatohen këto tavane më të larta ose,, nëse është e zbatueshme, do të zbatohen tavanet më të lartë të kësaj Rregulloreje.

4. Tavanet e fiksuara në paragrafët 2 dhe 3 do të zbatohen për intensitetin e ndihmës, llogaritur si një përqindje e kostove të pagave për një periudhë prej dy vitesh, në lidhje me punësimin e krijuar sipas kushteve në vazhdim:

(a) vendet e punës të krijuara duhet të përfaqësojnë një rritje neto të numrit të punonjësve si në momentin e krijimit, ashtu edhe në ndërmarrjen e konsoliduar, krahasuar me mesataren e 12 muajve të kaluara;

(b) vendet e punës të krijuara do të ruhen për një periudhë prej të paktën tre vitesh, ose dy vjetësh në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe;

(c) punonjësit e rinj, të punësuar si rezultat i krijimit të vendeve të reja, nuk duhet të kenë qënë të punësuar asnjëherë ose të kenë humbur, ose të jenë duke humbur punën e tyre të

mëparshme.

5. Kur ndihma është dhënë për krijimin e vendeve të punës sipas një skeme të përjashtuar në bazë të këtij neni, atëherë mund të jepet një ndihmë shtesë, në rastin e punësimit të punonjësve në vështirësi dhe punonjësve me aftësi të kufizuara, në përputhje me termat e nenit 5 ose 6.

Neni 5

Punësimi i punonjësve në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara

1. Skemat e ndihmës për punësim nga çdo ndërmarrje të punonjësve në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara dhe çdo ndihmë që mund të jepet sipas këtyre skemave, duhet të përmbushë kushtet e paragrafëve 2 dhe 3.

2. Intensiteti bruto i të gjithë ndihmës lidhur me punësimin e punonjësve në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara në fjalë, i llogaritur si një përqindje e kostove të pagave gjatë një periudhe prej një viti pas marrjes në punë, nuk duhet të kalojë 50% për punonjësit në vështirësi ose 60% për punonjësit me aftësi të kufizuara.

3. Do të zbatohen kushtet në vazhdim:

(a) kur punësimi nuk përfaqëson një rritje neto të numrit të punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, vendi ose vendet e punës duhet të jenë lënë vakant nga një largim vullnetar, dalje në pension, ulje vullnetare e orëve të punës ose largim i ligjshëm nga puna për sjellje të keqe dhe jo si rezultat i numrit të tepërt të punonjësve dhe;

(b) përveç rasteve të pushimit të ligjshëm nga puna për sjellje të keqe, punëtori ose punëtorët duhet të mbahen në punë pa shkëputje për të paktën 12 muaj.

Neni 6

Kostot shtesë për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara

1. Skemat e ndihmës për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara dhe çdo ndihmë që mund të jepet sipas këtyre skemave, duhet të përmbushin kushtet e paragrafëve 2 dhe 3.

2. Ndhimja për punësim, së bashku me çdo ndihmë të dhënë sipas nenit 5, nuk duhet të kalojë nivelin e dëshiruar për kompensimin e ndonjë produktiviteti të ulur për shkak të paaftësisë të punëtorit ose punëtorëve dhe për secilën nga kostot na vazhdim:

(a) kostot për përshtatjen e godinave;

(b) kostot e stafit të punësuar vetëm për kohën që harxhohet për asistencën e punëtorit ose punëtorëve me aftësi të kufizuara;

(c) kostot e përshtatjes ose blerjes së pajisjeve për përdorimin e tyre, të cilat janë shtesë e atyre kostove që përfituesi do të përballonte nëse do të punësonte punëtorë me aftësi jo të kufizuara, gjatë një periudhe për të cilën punonjësit me aftësi të kufizuara janë të punësuar.

Kur përfituesi ofron punësim me garantim të strehimit, ndihma mund të mbulojë me kusht që të mos kalojë, kostot e ndërtimit, instalimit ose zgjerimit të ndërmarrjes në fjalë si edhe çdo kosto administrimi dhe transporti ,të cilat rezultojnë nga punësimi i punëtorëve me aftësi të kufizuara.

3. Skemat e përjashtuara nga ky nen duhet të sigurojnë se ndihma ka kushtin që përfituesi të ruajë të dhënat me synim kontrollin dhe ,se ajo, i plotëson dispozitat e këtij neni dhe nenit 8 pika (4).

Neni 7

Domosdoshmëria e ndihmës

1. Kjo rregullore do të përjashtojë vetëm ndihmën sipas nenit 4, nëse më përpara punësimi në fjalë është krijuar:

(a) nga një kërkesë për ndihmë të përfituesit, drejtuar shteteve anëtare ose;

(b) shtetet anëtare kanë miratuar dispozita ligjore duke krijuar një të drejtë ligjore për ndihmë , në përputhje me kriteret objektive dhe pa një zgjedhje të tepruar nga shteti anëtar.

2. Ndihma do të përfitojë përjashtime sipas nenit 4 në rastet kur:

(a) punësimi i krijuar lidhet me zbatimin e një projekti investimi , në asete të prekshme dhe të paprekshme dhe;

(b) punësimi krijohet brenda tre viteve të përfundimit të investimit, vetëm nëse kërkesa e referuar në paragrafin 1pika (a), ose miratimi i referuar në paragrafin 1pika (b), është bërë përpara se të këtë nisur puna për këtë projekt.

Neni 8

Kumulimi

1. Tavanet e fiksuara të ndihmës në nenet 4, 5 dhe 6 , do të zbatohen pavarësisht faktit nëse mbështetja për punësim është financiar tërësisht nga burimet shtetërore , ose është financiar pjesërisht nga Komuniteti.

2 Ndhimja e dhënë sipas skemave të përjashtuara nga neni 4 i kësaj rregullore nuk do të përshtohet me ndonjë ndihmë tjetër shtetërore sipas kuptimit të nenit 87(1) të Traktatit ose me financime të tjera Komunitare për të njëjtat kosto pagash, nëse një përshtim i tillë do të rezultonte me një intensitet ndihme që do ta kalonte atë të fiksuar nga kjo rregullore.

3 Ndhimja e dhënë sipas skemave të përjashtuara nga neni 4 i kësaj rregullore nuk do të përshtohet :

(a) me çdo ndihmë tjetër shtetërore sipas kuptimit të nenit 87 pika (1) të Traktatit ose me financime të tjera Komunitare për kostot e çdo investimi me të cilin është i lidhur punësimi i krijuar dhe që nuk ka përfunduar akoma në momentin që punësimi është krijuar, ose që ishte plotësuar tre vite përpara se punësimi të krijohet ose;

(b) me ndonjë ndihmë ose financim për të njëjtat kosto pagash ose punësim tjetër të lidhur me të njëjtin investim, nëse një përshtim i tillë do të rezultonte në një intensitet ndihme që kalon tavanin përkatës të ndihmës rajonale për investim, të përcaktuar në udhëzimet për ndihmën rajonale dhe në hartën e miratuar nga Komisioni për çdo shtet anëtar, ose kufijtë e Rregullores (KE) nr. 70/2001. Kur tavanin përkatës në një rast të caktuar është vendosur në bazë të rregullave të ndihmës shtetërore të zbatuara në një sektor të caktuar ,ose në bazë të një instrumenti që zbatohet për projektet e mëdha të investimit, të tilla si kuadri shumësektorial për ndihmën rajonale për zbatimin e projekteve të mëdha të investimit, për qëllimet e këtij paragrafi, do të zbatohet tavanin i përshtatur .

4. Si një përjashtim nga paragrafët 2 dhe 3, ndihma sipas skemave të përjashtuara nga nenet 5 dhe 6 të kësaj rregullore mund të përshtohet me ndihma të tjera shtetërore sipas kuptimit të nenit 87 pika (1) të Traktatit ose me financime të tjera Komunitare, për të njëjtat kosto page përfshirë ndihmën sipas skemave të përjashtuara nga neni 4 i kësaj rregullore, të cilat janë në përputhje me paragrafët 2 dhe 3, pa u siguruar që një përshtim i tillë nuk do të rezultonte në një intensitet bruto të ndihmës , që do të kalonte 100% të kostos së pagave gjatë një periudhe për të cilën janë punësuar punëtorët ose punëtorët. Nënparagrafi i parë nuk preket nga një tavan më i ulët i intensitetit të ndihmës, që mund të jetë sipas kuadrit ligjor të Komunitetit për ndihmën shtetërore ,për kërkim dhe zhvillim.

Neni 9

Ndhimja që duhet njoftuar paraprakisht pranë Komisionit

1. Skemat e ndihmës, që janë përcaktuar për sektorë të caktuar, nuk do të përjashtohen nga njoftimi sipas kësaj rregullore dhe do të mbeten subjekt i detyrimit për njoftim të nenit 88 pika (3) të Traktatit.

2. Kjo rregullore nuk do të përjashtojë nga njoftimi grantet e ndihmës për një ndërmarrje të vetme ose një stabiliment, që kalon një vlerë bruto ndihme prej 15 milion Euro gjatë një periudhe prej tre vjetësh. Komisioni do ta vlerësojë një ndihmë të tillë, nëse është dhënë, në bazë të një skeme e cila është e përjashtuar nga kjo rregullore, duke iu referuar vetëm kushteve të kësaj rregullore.

3. Kjo rregullore nuk i përjashton shtetet anëtare nga njoftimi i granteve individuale të ndihmës sipas detyrimeve në kuadër të instrumentave të tjerë të ndihmës shtetërore dhe, në veçanti, të detyrimeve për të njoftuar ose për të informuar Komisionin për një ndërmarrje që merr ndihmë për ristrukturim sipas kuptimit të udhëzimeve të Komunitetit për ndihmën shtetërore, për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në vështirësi, si dhe në bazë të detyrimit për të njoftuar ndihmën rajonale për projektet e mëdha të investimit, që bien në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor shumë sektorial.

4. Skemat e ndihmës për nxitjen e marrjes në punë të kategorive të punonjësve të cilët nuk janë me aftësi të kufizuara sipas kuptimit të nenit 2 pika (f) do të mbeten subjekt i kërkesës për njoftim të nenit 88 pika (3) të Traktatit përveç rasteve të përjashtuara sipas nenit 4. Në njoftim, shtetet anëtare do të paraqesin për vlerësim nga Komisioni, argumente që tregojnë se punonjësit në fjalë janë me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim do të zbatohet neni 5.

5. Ndihma për të mbajtur vendet e punës, kryesisht mbështetja financiare e dhënë për një ndërmarrje për të mbajtur ende në punë punonjësit, të cilët në të kundërt do të pushoheshin, do të mbetet subjekt i kërkesës për njoftim të nenit 88 pika (3) të Traktatit. Në varësi të ndonjë rregulli të veçantë sektorial, një ndihmë e tillë mund të autorizohet nga Komisioni vetëm nëse në përputhje me nenin 87 pika (2) të Traktatit, ajo synon të rregullojë dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose rrethanat e jashtëzakonshme ose sipas kushteve të zbatuara për ndihmën rajonale në udhëzimet për ndihmën kombëtare rajonale, në rajonet të pranueshëm për përjashtim sipas nenit 87(3)(a), lidhur me zhvillimin ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është jashtëzakonisht i ulët ose kur ekziston një papunësi e lartë.

6. Ndihma për shndërrimin e kontratave të përkohshme ose të pandryshuara të punësimit në kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar, do të mbetet subjekt i kërkesës për njoftim të nenit 88 pika (3) të Traktatit.

7. Skemat e ndihmës për ndarjen e punës për ofrimin e mbështetjes për patentat e punës dhe masat e ngjashme të punësimit, të cilat nxisin punësimin por që nuk çojnë në një rritje neto të punësimit, në marrjen në punë të punonjësve në vështirësi ose të punonjësve me aftësi të kufizuara, do të mbeten subjekt i kërkesës për njoftim të nenit 88(3) të Traktatit dhe do të vlerësohet nga Komisioni në përputhje me nenin 87.

8. Masat e tjera të ndihmës me objekte që lidhen me punësimin dhe tregjet e punës, të tilla si masat për të nxitur daljen para kohe në pension, do të jenë gjithashtu subjekt i kërkesës për njoftim të

Nenit 88 pika (3) të Traktatit dhe do të vlerësohen nga Komisioni në përputhje me nenin 87.

9. Rastet individuale të ndihmës për punësim të dhënë jashtë ndonjë skeme, do të mbeten subjekt i kërkesës për njoftim të nenit 88 pika (3) të Traktatit. Një ndihmë e tillë do të vlerësohet në bazë të kësaj rregulloreje dhe mund të autorizohet nga Komisioni vetëm nëse ajo është në përputhje me ndonjë rregull të veçantë, i cili mund të jetë miratuar për sektorin në të cilin vepron përfituesi dhe vetëm nëse mund të tregohet që efektet e ndihmës në punësim janë më të mëdha se ndikimi në konkurrencë në tregun përkatës.

Neni 10

Transparenca dhe vëzhgimi

1 Gjatë zbatimit të një skeme të përjashtuar nga kjo rregullore, Shtetet Anëtare duhet që brenda 20 ditëve punë, të dërgojnë pranë Komisionit një përmbledhje të informacionit në lidhje me këtë skemë ndihme në formën e dhënë në Shtojcën I, me qëllim që të botohet në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian. Ky informacion duhet të sigurohet në formë të kompjuterizuar.

2 Shtetet Anëtare do të mbajnë të dhëna të detajuara lidhur me skemat e ndihmës të përjashtuara nga kjo rregullore dhe ndihmave individuale të dhëna sipas këtyre skemave. Të dhëna të tilla duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar që kushtet e përjashtimit, ashtu si janë dhënë në këtë rregullore, janë përmbushur duke përfshirë informacionin mbi statusin e çdo ndërmarrjeje për të cilin e drejta për të përfituar ndihmë varet nga statusi i saj si një SME. Shtetet Anëtare duhet të mbajnë të dhëna për një skemë ndihme për 10 vjet, nga data në të cilën është dhënë ndihma e fundit individuale, sipas kësaj skeme. Shteti Anëtar në fjalë, nëse ka një kërkesë me shkrim, duhet t'i sigurojë Komisionit brenda 20 ditëve punë ose një periudhe kohe të përcaktuar në kërkesën e Komisionit, të gjithë informacionin të cilin Komisioni e konsideron si të rëndësishëm për të vlerësuar nëse kushtet e kësaj rregullore janë përmbushur.

3. Shtetet Anëtare duhet të plotësojnë një raport për zbatimin e kësaj rregulloreje, gjatë një viti kalendarik ose për një pjesë të caktuar të vitit kalendarik, gjatë të cilit kjo rregullore zbatohet, në formën e përcaktuar në Shtojcën II, në formë të kompjuterizuar. Shtetet Anëtare duhet t'i sigurojnë Komisionit këtë raport, jo më vonë se tre muaj mbas mbarimit të afatit, të cilit i referohet raporti.

Neni 11

Hyrja në fuqi, periudha e fuqisë ligjore dhe dispozita kalimtare

1. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi 20 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.

Ajo do të mbetet në fuqi deri, më 31 dhjetor 2006.

2. Njoftimet e mbetura pezull, në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore ,do të vlerësohen në përputhje me dispozitat e saj.

Skemat e ndihmës të vëna në zbatim para hyrjen së fuqi të kësaj Rregullore dhe ndihma e dhënë sipas këtyre skemave, në mungesë të një autorizimi nga Komisioni dhe në përputhje me detyrimet e nenit 88 pika (3) të Traktatit, do të jenë në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 87 pika (3) të Traktatit dhe do të përjashtohen sipas kësaj rregullore nëse ato përmbushin kushtet e dhëna në nenin 3(1)(a) dhe nenin 3(2). Çdo ndihmë, që nuk përmbush këto kushte, do të vlerësohet nga Komisioni në përputhje me udhëzimet, komunikatën ose njoftimin përkatës.

3. Në fund të periudhës së vlefshmërisë të kësaj rregulloreje, skemat e ndihmës të përjashtuara sipas kësaj rregullore ,do të mbeten të përjashtuara gjatë një periudhe përshtatjeje prej gjashtë muajsh.

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Hartuar në Bruksel, 12 dhjetor 2002.

Për Komisionin

Mario Monti

Anëtar i Komisionit

- (1) GZ L 142,14.5.1998, fq. 1.
- (2) GZ C 88, 12.4.2002, fq.2.
- (3) GZ C 334, 12.12.1995, fq.4.
- (4) GZ C 1, 3.1.1997, fq. 10.
- (5) GZ C 74, 10.3.1998, fq. 9.
- (6) GZ L 10, 13.1.2001, fq. 33
- (7) GZ C 371, 23.12.2000, fq.
- (8) GZ C 218, 27.7.1996, fq.4.
- (9) GZ L 10, 13.1.2001, fq 30.
- (10) GZ L 202, 18.7.1998, fq. 1
- (11) GZ L 205, 2.8.2002, fq. 1
- (12) GZ L 107, 30.4.1996, fq. 4
- (13) GZ C 288, 9.10.1999, fq. 2.
- (14) GZ C 70, 19.3.2002, fq. 8.
- (15) GZ L 160, 26.6.1999, fq. 80.
- (16) GZ C 45, 17.2.1996, fq. 5.

SHTOJCA I

Informacioni i komunikuar nga Shtetet Anëtare lidhur me ndihmën shtetërore të dhënë sipas Rregullores (KE) Nr. 2204/2002 e datës 12 Dhjetor 2002 mbi zbatimin neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE për ndihmën shtetërore për punësim (dërgohet në formë të kompjuterizuar, me postë elektronike ,në adresën stateaidgreffe@cec.eu.int).

Numri i ndihmës.

Shpjegim: ky numër do të plotësohet nga DG COMP.
Shteti Anëtar. Rajoni.

Shpjegim: tregoni emrin e rajonit nëse ndihma është dhënë nga një autoritet jo qendror.
Titulli i skemës së ndihmës.

Shpjegim: tregoni emrin e skemës së ndihmës.

Baza ligjore.

Shpjegim: tregoni referencën e saktë të legjislacionit kombëtar për ndihmën dhe një reference publikimi.
Shpenzimi vjetor i planifikuar sipas skemës.

Shpjegim: vlerat duhet të jepen në euro ose nëse është e zbatueshme në monedhën kombëtare.

Tregoni vlerën e përgjithshme vjetore të buxhetit të përcaktuar për këtë qëllim ,ose një vlerësim vejtore të humbjes në taksa për të gjitha instrumentet e ndihmës që përmban skema.

Për garancitë tregoni vlerën(më të madhe) e kredive të garantuara.

Intensiteti më i madh i ndihmës sipas:

— Neni 4: krijimi i vendeve të reja të punës;

— Neni 5: marrjen në punë të punonjësve në vështirësi dhe punonjësve me aftësi të kufizuara;

— Neni 6: kostot shtesë të punësimit të punonjësve me aftësi të kufizuara.

Shpjegim: tregoni intensitetin maksimal të ndihmës duke bërë dallimin midis ndihmës sipas neneve 4, 5, dhe 6 të Rregullores.

Data e zbatimi

Shpjegim: tregoni datën nga e cila ndihma mund të jepet sipas skemës.

Kohëzgjatja e skemës.

Shpjegim: tregoni datën (vitin dhe muajin)deri kur mund të jepet ndihma sipas skemës.
Objektivi i ndihmës

— Neni 4: krijimi i vendeve të reja të punës:

— Neni 5: marrjen në punë të punonjësve në vështirësi dhe punonjësve me aftësi të kufizuara:

— Neni 6: kostot shtesë të punësimit të punonjësve me aftësi të kufizuara.

Shpjegim: qëllimi/qëllimet parësor/parësore të masës duhet të dallohen ndërmjet tre opsioneve. Gjithashtu kjo fushë krijon mundësi për të treguar objektiva të tjera (sekondarë).

Sektorët ekonomikë në fjalë:

— të gjithë sektorët e Komunitetit;

— i gjithë prodhimi;

— të gjithë shërbimet;

— tjetër (ju lutem specifikoni).

Shpjegim: kur është e mundur zgjidh nga lista. Skemat e ndihmës të cilat synojnë sektorë të veçantë nuk janë të përjashtuara nga njoftimi sipas kësaj rregullore.

Emri dhe adresa e autoritetit dhënës.

Shpjegim: Ju lutem tregoni numrin e telefonit dhe kur është e mundur edhe adresën e postës elektronike.

Me përjashtim të sektorit të ndërtimit të anijeve dhe sektorëve të tjerë , të cilët janë subjekt i rregullave të veçanta në rregullore dhe direktiva të ndihmës shtetërore në këta sektorë .

Informacion tjetër.

Shpjegim: Nëse skema është bashkëfinancuar nga fondet e Komunitetit, ju lutem shtoni fjalinë në vazhdim:

‘Skema është e bashkëfinancuar sipas [referencës].’

Nëse kohëzgjatja e skemës shkon tej datës së qënies në fuqi të kësaj Rregulloreje , ju lutem shtoni fjalinë në vazhdim:

‘Rregullorja e përjashtuar, shfuqizohet ,më 31 dhjetor 2006 e ndjekur nga një periudhë tranzitore prej gjashtë muajsh.’

SHTOJCA II

Formulari i raporteve periodike që do të dorëzohet pranë Komisionit

Formulari i raportimit vjetor të skemave të ndihmës ,të përjashtuar sipas një grupi të rregulloreve të përjashtimit , miratuar në bazë të nenit 1 të (KE) nr. 994/98

Shteteve anëtare u kërkohet të përdorin formularin e mëposhtëm për detyrimin e tyre për raportim , pranë Komisionit ,sipas rregulloreve të grupit të përjashtimit të miratuar mbi bazën e Rregullores (KE) nr. 994/98.

Raportet do të dërgohen në formë elektronike në:

stateaidgreffe@cec.eu.int

Informacioni i kërkuar për të gjitha skemat e ndihmës ,të përjashtuara sipas rregulloreve të

grupit të përjashtimeve, të miratuar sipas nenit 1 të Rregullores (KE) nr. 994/98 :

1 .Titulli dhe nr. i skemës së ndihmës;

2 .Zbatimi i rregullores së përjashtimit të Komisionit;

3. Shpenzimi.

Duhet të sigurohen të dhëna për çdo instrument ndihme brenda skemës (p.sh. grant, kredi e butë, etj.). Të dhënat duhet të jenë në euro ose nëse është zbatueshme, në monedhën kombëtare. Në rastin e shpenzimit të taksave, duhet të raportohen humbjet vjetore nga taksat.

Nëse të dhënat e sakta nuk janë të disponueshme, të tilla humbje mund të vlerësohen.

Të dhënat për shpenzimin duhet të sigurohen mbi bazën e mëposhtme:

Për vitin në fjalë tregoni veçmas për çdo instrument ndihme brenda skemës (p.sh. grant, kredie butë, garanci, etj.):

3.1. Vlerat e përcaktuara, humbjet (e vlerësuara) në taksa ose të ardhura të tjera prej të cilave hiqet dorë, të dhëna për garancitë, etj. për vendimet e reja për të dhënë ndihmë. Në rastin e skemave të garancisë, duhet të sigurohet vlera totale e garancisë së re.

3.2. Pagesat aktuale, humbjet (e vlerësuara) në taksa ose të ardhurat prej të cilave hiqet dorë, të dhëna mbi garancitë, (etj.) , për grantet e reja dhe ato aktuale. Në rastin e skemave të garancisë duhet të sigurohet: vlera totale e garancisë, të ardhurat nga primet, kthimet, zhdëmtimet e paguara, rezultatet operacionale të skemës gjatë vitit në fjalë.

3.3. Numri i vendimeve të reja për të dhënë ndihmë.

3.4. Një vlerësim i përgjithshëm i vendeve të punës të krijuara ose punonjësve në vështirësi, ose me aftësi të kufizuara, sipas një vendimi të ri për të dhënë ndihmë. Ndhima për rekrutimin e punonjësve në vështirësi duhet të ndahet nga kategoritë e nenit 2(f).

3.5.

3.6. Zbritjet rajonale të vlerave sipas nenit 3.1 si për rajonet e përcaktuara në nivelin NUTS II ose nën këtë nivel ose nga rajonet e nenit 87(3)(a), rajonet e nenit 87(3)(c) dhe zonat e pa ndihmuara.

3.7. Zbritjet rajonale të vlerave sipas nenit 3.1 , sipas sektorëve përfitues (nëse mbulohet më shumë se një sektor, tregoni vlerën për secilin):

- qymyrguri
- prodhimi prej të cilit:
 - çeliku
 - anije
 - fibra sintetike
 - mjete motorike
 - prodhime të tjera
- shërbime prej të cilave:
 - shërbime të transportit
 - shërbime financiare
 - shërbime të tjera
- sektorë të tjerë (ju lutem specifikoni)

4. Informacione të tjera dhe shpjegime

(1) NUTS është nomenklatura e njësive territoriale për qëllime statistikore në Komunitetin Evropian.